


**FOL**



# **DORACAK PËR SINJALIZUESIT**



KORRIK, 2020

Titulli: Doracak për Sinjalizuesit

Autor: Nur Çeku

Viti i botimit: Korrik, 2020

Dizajni: Ardit Berisha

Publikuar nga Lëvizja FOL

Andrea Gropa nr.35

Prishtina 10000, Republika e Kosovës

info@levizjafol.org

+386 (0)49 131 542

Të drejtat e autorit © 2020. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.



Ky botim është realizuar me përkrahjen e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur. Përmbajtja e këtij raporti pasqyron pikëpamjet dhe mendimet e autorit që është përgjegjës për faktimin dhe saktësinë e të dhënave të prezantuara këtu. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu, jo domosdoshmërisht i paraqesin ato të Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur.

# PËRMBAJTJA

5	SFONDI
6	1. SINJALIZIMI DHE KUPTIMI I TIJ
6	Hyrje
6	1.1. Sektori publik
6	1.2. Sektori privat
6	1.3. Sinjalizimi
7	1.4. Sinjalizuesi
7	1.5. Motivi për të sinjalizuar
7	1.6. Ndalimi i keqpërdorimi të sinjalizimit
8	1.7. Të drejtat e sinjalizuesit
8	1.8. Personi i lidhur me sinjalizuesin
9	2. SHKELJET PËR TË CILAT MUND TË SINJALIZOHET
9	Hyrje
9	2.1. Dështimi për të përmbushur një detyrim ligjor
9	2.2. Keqadministrimi i drejtësisë
9	2.3. Rrezikimi i shëndetit apo sigurisë së individit
9	2.4. Dëmtimi i mjedisit
10	2.5. Keqpërdorim i pozitës zyrtare, parasë publike dhe pasurisë së institucionit
10	2.6. Veprimet diskriminuese dhe shtypëse
10	2.7. Fshehja apo shkatërrimi i informacionit
11	2.8. Afati kohor i sinjalizimit të shkeljeve
11	2.9. Besimi i arsyeshëm dhe dyshimi i bazuar mirë
11	2.10. Format e sinjalizimit
12	3. SHQYRTIMI I SINJALIZIMIT TË BRENDSHËM
12	Hyrje
12	3.1. Sinjalizimi i brendshëm
12	3.2. Zyrtari përgjegjës
12	3.3. Drejtuesi i institucionit si zyrtar përgjegjës
13	3.4. Parimet mbizotëruese të punës së zyrtarit përgjegjës

14	3.5.	Konfidencialiteti
14	3.6.	Regjistrimi dhe evidentimi i rastit
15	3.7.	Afatet e shqyrtimit të rastit
16	3.8.	Hetimi administrativ
16	3.9.	Palët në procedurë
16	3.10.	Përdorimi i gjuhës në procedurë
17	3.11.	Përfundimi i hetimit administrativ
17	3.12.	Veprimet pas përfundimit të hetimeve
17	4.	SHQYRTIMI I SINJALIZIMIT TË JASHTËM
17		Hyrje
17	4.1.	Sinjalizimi i jashtëm
18	4.2.	Sinjalizimi i jashtëm në sektorin publik
18	4.3.	Sinjalizim i jashtëm në sektorin privat
19	4.4.	Sinjalizimi lidhur me sigurinë kombëtare dhe marrëdhëniet ndërkombëtare
20	5.	SINJALIZIMI PUBLIK / SHPALOSJA E INFORMACIONIT
20		Hyrje
20	5.1.	Shpalosja publike
21	5.2.	Prezumimi i pafajësisë
21	6.	MBROJTJA E SINJALIZUESVE
21		Hyrje
21	6.1.	Mbrojtja e sinjalizuesve
22	6.2.	Parashtrimi i padisë
23	6.3.	Vendimet e gjykatës
23	6.4.	Barra e provës
23	6.5.	Masat e sigurimit të kërkesëpadisë
23	6.6.	Masat (gjobat) administrative
24		PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME
26		REFRENCAT

## SFONDI

Sinjalizuesit luajnë rol thelbësor në mbrojtjen e interesit publik duke raportuar apo shpalosur shkeljet e ndryshme të cilat të kryhen si në sektorin publik edhe privat. Të sinjalizuarit dhe mbrojtja e personave që sinjalizojnë është një prej të drejtave themelore që burojnë nga e drejta e lirisë së shprehjes e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës<sup>1</sup> dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut.<sup>2</sup> Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve (tutje Ligji) është një mekanizmi efikas për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe ofron një perspektivë të re në luftimin e dukurive negative dhe krijon një qasje afirmative për interesin publik. Komponenti më i rëndësishëm në këtë ligj është garantimi për mbrojtje për këdo që do të sinjalizojë një praktikë apo veprim që përbën shkelje të ligjit.<sup>3</sup>

Zbatimi i këtij Ligji, do të jetë një kontribut i rëndësishëm për arritjen e qëllimeve të përbashkëta për sundimin e ligjit në shoqërinë tonë. Por për zbatimin e Ligjit, është e domosdoshme, kuptimi i drejtë i dispozitave të tij nga të punësuarit në sektorin publik dhe privat. Ky Doracak shërben si udhërrëfyes për qytetarët dhe sinjalizuesit potencialë që kanë vullnetin e mirë që të sinjalizojnë shkeljet e ndryshme ligjore. Doracaku ju shërben edhe për të realizuar mbrojtjen që garanton ligji nga çdo veprim hakmarrës apo ndëshkimore që mund të vijë si rezultat i sinjalizimit. Doracaku është ndërtuar duke ju referuar përmbajtës së ligjit dhe duke ofruar shembuj apo modele të formave të shkresave të ndryshme gjatë procesit të sinjalizimit. Doracaku është i ndërtuar si një instrument i dobishëm për të ndihmuar të gjithë personat të cilët kanë guximin për të përshkruar shtegun e mbrojtjes së interesit publik duke sinjalizuar shkeljet e ndryshme. Ne jemi të vetëdijshëm për sfidat e zbatimit të ligjit, por le të fillojmë secili të bëjmë punën tonë. Nëse vendosni të ndërmerrni një udhëtim nëpër faqet e këtij dokumenti, ju do të mësoni më shumë rreth përmbajtjes së ligjit, mënyrës së zbatimit dhe mbrojtjes së sinjalizueseve.

---

<sup>1</sup>Kushtetuta e Kosovës, Neni 40 [ Liria e Shprehjes] <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>.

<sup>2</sup>Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, Neni 10 [ Liria e Shprehjes] [https://www.echr.coe.int/Documents/Convention\\_SQL.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_SQL.pdf)

<sup>3</sup>Ligji Nr. 065/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 22 /18 dhjetor 2018, Prishtinë. Ndërsa dispozitat që i referohen sektorit privat fillojnë të zbatohen një (1) vit pas hyrjes së tij në fuqi. Ligji reflekton dhe integron parimet dhe standardet evropiane të parapara me Rekomandimin e Këshillit të Evropës (2014)/7 dhe Direktivën e Parlamentit dhe Këshillit Evropian për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

# 1. SINJALIZIMI DHE KUPTIMI I TIJ

Hyrje: Ky kapitull diskuton konceptet kryesore mbi procesin e sinjalizimit. Në kuadër të tij, sqarohet kuptimi i sektorit publik, sektorit privat, llojet e sinjalizimit dhe motivet për të sinjalizuar. Mes tjerash sqarohet edhe raporti personal lidhur me sinjalizimin.

**1.1. Sektori publik** - sipas legjisllacionit përbëhet nga të gjitha institucionet apo organet e nivelit qëndror apo lokal, të cilat ushtrojnë kompetenca legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore, si dhe organizatat, agjencitë, ndërmarrjet publike dhe shërbimet në pronësi dhe menaxhim të shtetit.

**1.2. Sektori privat** - përbëhet nga të gjitha subjektet juridike (etnitete ligjore) jashtë sektorit publik. Ky sektor përfshinë shoqëritë tregtare, organizatat jo qeveritare dhe çdo organizatë tjetër e themeluar në bazë të ligjit.

**1.3. Sinjalizimi** - është raportimi apo shpалosja e informacionit në lidhje me shkeljet e ndryshme ligjore që mund të ndodhin në institucionet e sektorit publik dhe privat. Përmes sinjalizimit bëhet zbulimi i informacionit mbi aktivitetet e paligjshme, mashtruese ose të rrezikshme që kryhen brenda institucionit.

## TABELA NR.1

### LIGJI PËRCAKTON TRI LLOJE TË SINJALIZIMIT:

- SINJALIZIMI I BRENDSHËM
- SINJALIZIMI I JASHTËM
- SINJALIZIMI PUBLIK

**1.4. Sinjalizues** - është çdo person fizik i cili në kontekstin e marrëdhënies së tij të punës në një institucion të sektorit publik sinjalizon shkeljet e ndryshme ligjore. A nënkupton kjo që vetëm personat fizik të cilët janë në marrëdhënie pune kanë të drejtë të jenë sinjalizues? Jo, sipas ligjit ka disa kategori të personave të cilët kanë të drejtë të sinjalizojnë.

## TABELA NR.2

### PERSONAT NË KONTEKSTIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS NË SEKTORIN PUBLIK DHE PRIVAT JANË ATA PERSONA TË CILËT JANË APO KANË QENË:

- TË PUNËSUAR PAVARËSISHT NGA KOHËZGJATJA, PAGESA DHE NATYRA E PUNËS
- BASHKËPUNËTOR I JASHTËM APO I RASTIT
- KANDIDATËT PËR PUNËSIM, VULLNETARË, PERSONAT NË PRAKTIKË PROFESIONALE APO TRAJNIM
- KONTRAKTOR APO NËNKONTRAKTOR SHËRBIMESH

**1.5. Motivi për të sinjalizuar** - Motivet që ndikojnë për të sinjalizuar janë të ndryshme, por ligji vendos prezumimin e interesit publik për sinjalizim. Individët që raportojnë apo shpallsin praktikat e dyshimta apo shkeljet ligjore, kontribuojnë në forcimin e llogaridhënies dhe integritetit institucional dhe sundimit të ligjit. A mund të sinjalizohet për një interes apo pakënaqësi personale? Jo, Ligji, për mbrojtjen e sinjalizuesve, nuk përcakton se sinjalizimi mund të bëhet për ankesat personale. Në rast të pakënaqësisë apo interesit personal, individët ndjekin procedurat administrative brenda dhe jashtë institucionit apo edhe procedurat gjyqësore. Në rast se një person vendos të sinjalizojë ai duhet të jetë i bindur se është duke vepruar në interes publik.

**1.6. Ndalimi i keqpërdorimi të sinjalizimit** - në rastet kur sinjalizimi nuk kryhet sipas ligjit, apo sinjalizuesi paraprakisht është i vetëdijshëm se paraqet fakte të rreme, situata të sajura apo i motivuar nga interesat personale, kjo konsiderohet keqpërdorim i sinjalizimit. Dhe si i tillë është i ndaluar.

### TABELA NR.3

#### **INTERESI PUBLIK MBULON SHUMË ASPEKTE TË JETËS SË NJERËZVE SI:**

- TË DREJTAT THEMELORE TË NJERIUT
- SIGURINË NJERËZORE
- SHËNDETIN PUBLIK
- ZHVILLIMIN EKONOMIK
- MIRËQENIEN SOCIALE
- DINJITETIN DHE LUMTURINË E NJERËZVE
- TRASHËGIMINË E VLERAVE KULTURORE

**1.7. Të drejtat e sinjalizuesit** - të drejtat që përcakton Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve janë: mbrojtja e të dhënave personale; ruajtja e konfidencialitetit dhe mbrojtjen kundër veprimeve hakmarrëse. Këto të drejta garantohen gjatë marrëdhënies së tij të punës por edhe pas përfundimit të saj. Të njëjtat të drejta me sinjalizuesin i ka edhe personi i lidhur me sinjalizuesin.

**1.8. Personi i lidhur me sinjalizuesin** - Mund të ndodhë që sinjalizuesi të ndihmohet gjatë një procesi të sinjalizimit nga persona të tjerë. Por edhe mund të ngajë që një person për shkak të çfarëdo lidhje me sinjalizuesin të përjetoj ndonjë formë të hakmarrjes apo të dëmtohet. Ligji, këtë person e definon si person të lidhur me sinjalizuesin. Personi i lidhur me sinjalizuesin është ai person i cili ndihmon sinjalizuesin ose mund të ofrojë prova të lidhura me sinjalizimin, apo çdo person tjetër që mund të dëmtohet për shkak të çfarëdo lidhje me sinjalizuesin.



## 2. SHKELJET PËR TË CILAT MUND TË SINJALIZOHET

Hyrje: Ky kapitull diskuton katalogun e shkeljeve për të cilat mund të sinjalizohet. Termi “shkelje” është gjithëpërfshirës dhe Ligji nuk e definon në kuadër të përkufizimeve se çka është një “shkelje”. Sipas nenit 5 të Ligjit, përfshihen llojet e sjelljeve që çenojnë apo kërcënojnë interesin publik. Në vijim do të trajtohet natyra e këtyre shkeljeve dhe momenti kohor i kryerjes së sinjalizimit.

**2.1. Dështimi për të përmbushur një detyrim ligjor** - në rast së një person në kuadër të autorizimeve të tij/saj ligjore, dështon për të përmbushur detyrimet e tij/saj në kohë, në standardin e duhur kjo mund të ketë pasoja në rezultatin e punës së organizatës. Prandaj një rast i tillë mund të sinjalizohet.

**2.2. Keqadministrimi i drejtësisë** - mund të ndodh kur institucionet e drejtësisë nuk veprojnë në përputhje me një rregull apo parim i cili është i detyrueshëm për këto institucione. Twa drejtat ligjore të garantuara jetësohen kur institucionet përgjegjëse japin drejtësi me kohë dhe drejtësia administrohet në mënyrë të duhur. Jo rrallë mund të ketë keqadministrim të drejtësisë nga institucionet dhe personat përgjegjës, që kryhet përmes veprimeve si: ushtrimi i ndikimit; ryshfeti; fshehja e provave relevante; falsifikimi i dokumenteve; pakujdesia, neglizhimi; mos qasja në drejtësi, etj.

**2.3. Rrezikimi i shëndetit apo sigurisë së individit** - në sektorin publik apo privat mund të ndodhin veprime të ndryshme përmes të cilave rrezikohet shëndeti apo siguria e individit. Ambienti i punës; kujdesi shëndetësor, kryerja jo profesionale e shërbimeve spitalore; cilësia dhe siguria e ushqimit; e ujit; etj. janë disa nga fushat në kuadër të së cilave mund të ketë rrezikim të shëndetit dhe sigurisë së individit dhe në raste të tilla këto veprime mund të sinjalizohen.

**2.4. Dëmtimi i mjedisit** - paraqet një shkelje e cila mund të ndodh nga veprimet e ndryshme si ndotja e ujit; ndërtimet pa leje, dëmtimi i lumenjve; prerja e pyjeve; djegia e mbeturinave, zjarrvënia e qëllimshme, peshkimi dhe gjuetia pa leje, etj.

**2.5. Keqpërdorim i pozitës zyrtare, parasë publike dhe pasurisë së institucionit** - këto veprime janë shkelje të cilat lidhen me korrupsionin; konfliktin e interesit; ushtrimin e ndikimit; pastrimit të parave; keqpërdorimet në prokurimin publik; mashtrimet me tenderë; punësimet; etj.

**2.6. Veprimet diskriminuese dhe shtypëse** - këto veprime (shkelje) kryesisht lidhen me të drejtat e njeriut. Në fakt, diskriminimi i çfarëdo forme është i ndaluar edhe me Kushtetutë dhe mekanizmat kryesore ndërkombëtare. Këto veprime mund të kryhen nga pakujdesia e personave përgjegjës apo nga keqmenaxhimi i rëndë.

**2.7. Fshehja apo shkatërrimi i informacionit** - ligji përcakton se përbëjnë shkelje edhe veprimet që kanë për qëllim të fshehin apo shkatërrojnë informacioni që synon të tregojë për shkeljet e ndryshme të cilat besohet se kanë ndodhur. Pra, duke fshehur apo shkatërruar informacionin relevant atëherë minimizohet apo humbet edhe mundësia e trajtimit të sinjalizimit.

#### **TABELA NR.4**

##### **TOP FUSHAT NË TË CILAT MUND TË KRYHEN SHKELJE APO PRAKTIKA TE DYSHIMTA:**

- PROKURIMI PUBLIK
- ADMINISTRIMI I DREJTËSISË DHE BARAZIA PARA LIGJIT;
- SHËRBIMET FINANCIARE, PARANDALIMI I PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMI I TERRORIZMIT
- SIGURIA E TRANSPORTIT
- MBROJTJA E MJEDISIT
- SIGURIA E USHQIMIT, SHËNDETIT DHE MIRËQENIA E NJERËZVE
- MBROJTJA E KONSUMATORIT
- MBROJTJA E KONKURENCËS
- MBROJTJA E PRIVATËSISË DHE TË DHËNAVE PERSONALE
- SIGURIA E RRJETEVE DHE SISTEMEVE TË INFORMACIONIT

**2.8. Afati kohor i sinjalizimit të shkeljeve** - nuk ka kufizim kohor brenda të cilit mund të sinjalizohet shkelja. Ligji përcakton se ato mund të raportohen apo shpalosen nëse “shkelja është kryer, është duke u kryer apo ka gjasa që të kryhet.” Varësisht në çfarë faze sinjalizohet një shkelje mund të pengohet shkaktimi i dëmit, mund të bëhet parandalimi i shkeljes apo veprimet dyshues.

**2.9. Besimi i arsyeshëm dhe dyshimi i bazuar mirë** - ligji u referohet “shkeljeve” në mënyrë të përgjithësuar për arsye se sinjalizimet në fakt janë dyshime, prandaj ligji përdorë termin “besim të arsyeshëm” e jo “dyshimin e bazuar mirë”. Termi “besim i arsyeshëm” nënkupton së sinjalizuesi në momentin e sinjalizimit beson me vetëdije se ekziston kërcënimi apo cenimi i interesit publik. Edhe në rast se kërcënimi apo cenimi i interesit publik nuk është materializuar, prapëseprapë sinjalizimi është veprimi i duhur. Mos materializimi është situata kur shkelja apo praktika dyshuese e sinjalizuar nuk ka ndodhur, nuk është duke ndodhur dhe nuk do të ndodhe realisht, dhe nuk ka cenim të interesit publik. Sinjalizuesi nuk është i detyruar të provojë mirëbesimin dhe vërtetësinë e informacionit të sinjalizuar, dhe nuk ka detyrim të mbledhë apo siguroj prova.

**2.10. Format e sinjalizimit** - sinjalizimi mund të bëhet me (i) shkrim; (ii) e-mail; (iii) poste dhe (iv) gojarisht. Në rast të sinjalizimit gojor, zyrtari përgjegjës përpilon një shkresë/deklaratë sipas deklaramit të sinjalizuesit të cilën e nënshkruajnë bashkërisht zyrtari përgjegjës dhe sinjalizuesi.

## TABELA NR.5

### FORMAT E SINJALIZIMIT JANË:

- ME SHKRIM
- ME POSTË/E-MAIL
- GOJARISHT

## 3. SHQYRTIMI I SINJALIZIMIT TË BRENDSHËM

Hyrje: Ky kapitull trajton shqyrtimin e sinjalizimit të brendshëm i cili bëhet në institucionet e sektorit publik dhe privat. Mes tjerash përshkruhen detyrimet e institucioneve dhe zyrtarëve përgjegjës dhe shqyrtimin e sinjalizimeve. Kapitulli trajton edhe afatet procedurale për shqyrtimin e sinjalizimit të brendshëm dhe veprimet e nevojshme pas përfundimit të procesit.

**3.1. Sinjalizimi i brendshëm** – është sinjalizimi (raportimi) i shkeljeve që bëhet brenda institucionit të sektorit publik dhe privat. Sinjalizimi i brendshëm konsiderohet si mënyra më e mirë për të marrë informacione relevante të cilat mund të kontribuojnë në zgjidhjen e hershme dhe efektive të rreziqeve dhe kërcënimeve ndaj interesit publik. Sinjalizimi është vullnetar dhe asnjë person nuk mund të detyrohet të sinjalizojë. Por kur sinjalizohet, atëherë është detyrim ligjor shqyrtimi i tij.

**3.2. Zyrtari përgjegjës** - raportimi i brendshëm i sinjalizimit bëhet tek zyrtari përgjegjës i caktuar për të trajtuar sinjalizimin. Institucionet e sektorit publik që kanë me shumë se pesëmbëdhjete (15) të punësuar dhe organizatat e sektorit privat me më shumë se 50 të punësuar, janë të detyruar të caktojnë zyrtarin përgjegjës për shqyrtimin e sinjalizimeve. Në rast se numri i të punësuarave është më i vogël, sinjalizimi i brendshëm bëhet tek drejtuesi i institucionit.<sup>4</sup>

**3.3. Drejtuesi i institucionit si zyrtar përgjegjës** - sinjalizimi parimisht, bëhet tek zyrtari përgjegjës por përjashtimisht mund të bëhet tek drejtuesi i institucionit publik në disa raste të veçanta si në vijim: (i) institucioni nuk ka zyrtar përgjegjës; (ii) zyrtari përgjegjës është i përfshirë në rastin e dyshuar; (iii) dyshimi i arsyeshëm se zyrtari është i papërshtatshëm për të paraqitur rastin; (iv) dyshim i arsyeshëm se procedurat e brendshme nuk janë efektive. Në raste të tilla drejtuesi i institucionit është zyrtari përgjegjës për trajtimin e rastit të sinjalizimit.

---

<sup>4</sup>Për caktimin e zyrtarëve përgjegjës shih Raportin e Lëvizjes FOL “ Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve - Sfidat e zbatimit në praktikë” Qershor 2020/  
<https://levizjafol.org/wp-content/uploads/2020/06/Ligji-p-C3%ABr-Mbrojtjen-e-Sinjalizuesve-%E2%80%93-Sfidat-e-zbatimit-t-C3%AB-praktik-C3%AB..pdf>

3.4. Parimet mbizotëruese të punës së zyrtarit përgjegjës - ndershmëria, efikasiteti dhe legjitimiteti i sinjalizimit; konfidencialiteti, neutraliteti ndaj ndikimeve politike dhe ndikimeve tjera dhe shmangia e konfliktit të interesit, janë parimet kyçe të zyrtarit përgjegjës për sinjalizim.

## TABELA NR.6

Forma e raportimit të sinjalizimit (model/draft)

### RAPORTIM

#### LIDHUR ME SHKELJEN ME RASTIN E REKRUTIMIT TË STAFIT DHE DËMTIMIT TË INTERESIT PUBLIK NË MINISTRINË E ZHVILLIMIT URBAN

Unë jam i punësuar qe 7 vite në këtë Ministri. Aktualisht jam auditor i brendshëm. Gjatë punës sime kam pasur rastin të shoh parregullsi, praktika dyshuese dhe lëshime në fushat e caktuara, por sidomos në punësimet e stafit. Rasti i fundit ka qenë gjatë vitit 2020, kur janë punësuar disa persona përmes ushtrimit të ndikimeve dhe në mënyrë jo meritore. Unë kam audituar procesin dhe kam dhënë disa rekomandime për menaxhmentin e lartë. Menaxhmenti është përgjigjur se është përgjegjësi e komisionit të rekrutimit dhe se si menxhment nuk kanë pasur kurrfarë ndikimi. Po kanë thënë se procesi është në rregull dhe në pajtim me procedurat ligjore.

Unë besoj se ky proces ka pasur parregullsi dhe ka dëmtuar interesin publik. Anëtarët e komisionit selektues, sipas diskutimeve jo formale kanë qenë në dijeni se procesi ka parregullsi por kanë heshtur. Njëri nga anëtarët e komisionit të pranimit dyshohet se ka qenë në konflikt interesi. Prandaj unë raportoju këtë rast në baze të informacioneve dhe disa të gjeturave tek zyrtari për sinjalizim.

Raportit ia bashkëngjesë edhe dokumentet si në vijim: (1) vendimin për shpalljen e konkursit; (2) vendimin për komisionin e selektimit; (3) termat e referencës; (4) vendimin e komisionit të selektimit; (4) ankesat e kandidatëve të pakënaqur dhe (5) raportin me të gjeturat.

Prishtinë, datë 00.00.2020

Raportuesi: Shkëlqim Shkëlqimi

**3.5. Konfidencialiteti** - është parim kyç në procedurën e trajtimit të sinjalizimit. Zyrtari përgjegjës në çdo kohë ruan konfidencialitetin e informacionit të raportuar duke mos e transmetuar tek personat e tretë brenda apo jashtë institucionit. A mundet që informacioni i sinjalizuar të përdoret për qëllime të tjera? Kjo mund të bëhet përjashtimisht në dy situata: a) me pëlqim me shkrim të sinjalizuesit dhe b) për parandalimin e ndonjë krimi apo procesi penal, për sigurinë e shtetit, sigurinë e shëndetin publik dhe mjedisin.

### TABELA NR.7

#### PËRMBAJTTJA E PARIMIT TË KONFIDENCIALITETIT:

- PERSONAT E SINJALIZUAR NUK NJOFTOHEN
- MBAHET FSHEHTË IDENTITETI I SINJALIZUESIT
- ËLQIMI ME SHKRIM I SINJALIZUESIT PËR ZBULIMIN E IDENTITETIT
- RUAJTA E INFORMATAVE APO TË DHËNAVE NË SINJALIZIM

**3.6. Regjistrimi dhe evidentimi i rastit** - procedura e shqyrtimit fillon nga momenti kur raportohet informacioni për shkeljen e pretenduar tek zyrtari përgjegjës. Zyrtari përgjegjës pranon informacion në njërin nga tri format e paraqitjes se tij (shih tabelën nr.8) duke krijuar një Regjistër i cili përmbanë të dhënat kryesore për sinjalizuesin dhe datën e pranimit. Në fakt, ky regjistër është libri (blloku) i regjistrit në të cilin regjistrohen rastet me radhë dhe të cilat sinjalizohen në institucionin përkatës të sektorit publik. Sinjalizuesit me rastin e parashtrimit të rastit i jepet dëshmi për informacionin e paraqitur dhe lista me emrat e dokumenteve të cilat janë paraqitur lidhur me rastin.

## TABELA NR.8

### FLETË EVIDENCA/ PROPOZIM EMRI I INSTITUCIONIT: MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

Ref. nr. 2222/33

Prishtinë, 11. 33. 2020

Përmbajtja e dokumentacionit të dorëzuar te zyrtari përgjegjës për trajtimin e sinjalizimit lidhur me raportimin (sinjalizim), shkeljen (keqpërdorimin) e detyrës zyrtare në rastin e lidhjes së kontratës për furnizimin me materiale shpenzuese të zyrave në Ministrinë e Zhvillimit Urban:

1. Raporti (deklarata) e sinjalizuesit;
2. Kontrata (kopje);
3. Procesverbali i takimit;
4. Certifikata e biznesit;
5. Fatura e pagesave;
6. Raporti i auditimit të brendshëm;
7. E-mali i datës .....;
8. Ankesat e stafit për mungesë të materialit;

Përfundon me nr. rendor 8.

Nënshkruar nga zyrtari përgjegjës:

Nënshkrimi: .....

**3.7. Afatet e shqyrtimit të rastit** - rastet e sinjalizimit duhet të trajtohen sa më shpejt që është e mundur. Pas raportimit, brenda afatit 15 ditor, zyrtari përgjegjës (punëdhënësi) e njofton sinjalizuesin për statusin e sinjalizimit. Pra, gjatë këtij afati, informacioni filtrohet dhe varësisht nga përmbajtja e tij do të vlerësohet nëse do të vijohet tutje me hetimin administrativ të rastit. Afati për shqyrtimin e rastit të sinjalizimit është 45 ditë dhe në rast të rrethanave specifike, përjashtimisht, mund të zgjasë edhe 45 ditë tjera, duke mbyllur ciklin kohorë prej 90 ditësh nga dita e regjistrimit të rastit.

**3.8. Hetimi administrativ** – në procedurën e shqyrtimit të sinjalizimit paraqet fazën kryesore. Gjatë kësaj faze bëhet vlerësimi i fakteve dhe rrethanave relevante për trajtimin e rastit. Nëse është e nevojshme, zyrtari përgjegjës, mund të kërkoj informacione shtesë nga personat relevantë, të urdhëroj inspektime dhe të konsultohet me ekspert përkatës. Këto veprime ndihmojnë zyrtarin përgjegjës të zbatoj një hetim të plotë, të përshtatshëm dhe të saktë për të sqaruar të vërteten objektive. Gjatë hetimit administrativ zbatohen parimet e ligjit për procedurën e përgjithshme administrative.<sup>5</sup>

**3.9. Palët në procedurë** - procedurën e hetimit administrativ e zhvillon zyrtari përgjegjës si përfaqësues i punëdhënësit, dhe palët në procedurë mund të jenë sinjalizuesi dhe personat e tretë që kanë lidhje me rastin. Palët kanë të drejtë: (i) të dëgjohen; (ii) të kenë qasje në dosjen e hetimit; (iii) të paraqesin prova, opinione apo deklarata.

## TABELA NR.9

### PALËT NË HETIMIN ADMINISTRATIV JANË:

- SINJALIZUESI
- PERSONI I TRETË QË KA DIJENI APO DOKUMENTACION PËR RASTIN NËN HETIM

**3.10. Përdorimi i gjuhës në procedurë** - gjatë hetimit administrativ, palëve iu garantohet përdorimi i gjuhës që e flet apo kupton në pajtim me ligjin për përdorimin e gjuhëve në Republikën e Kosovës.<sup>6</sup>

<sup>5</sup>Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/21 Qershor 2016. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=12559>

<sup>6</sup>Ligji Nr.02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, Prishtinë: VITI II/ Nr. 10/01 Mars 2007. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2440>.



**3.11. Përfundimi i hetimit administrativ** - nëse në përfundim të hetimit administrativ të sinjalizimit rezulton se veprimi apo praktikat në rastin e sinjalizuar paraqesin shkelje ligjore, zyrtari përgjegjës (punëdhënësi) merr masat sipas rezultateve të hetimit dhe nëse ka nevojë i dërgohet organeve kompetente për veprim të mëtejshëm. Organe kompetente në këtë rast mund të jenë organet e ndryshme, varësisht nga natyra e shkeljes administrative apo penale, si: komisionet disiplinore; Agjencia kundër Korrupsionit; Auditori i Përgjithshëm; Prokurori i Shtetit, etj.

**3.12. Veprimet pas përfundimit të hetimeve** - nëse në përfundim të hetimit administrativ rezulton se shkelja apo veprimi i sinjalizuar vijon të shkaktoj pasoja të dëmshme në interes publik, punëdhënësi merr masa të menjëhershme, për t'i parandaluar ato.

## 4. SHQYRTIMI I SINJALIZIMIT TË JASHTËM

Hyrje: Ky kapitull trajton formën e paraqitjes dhe shqyrtimit të sinjalizimit të jashtëm. Kjo formë e sinjalizimit është specifike për shkak të organeve kompetente të ndryshme që e shqyrtojnë atë në sektorin publik dhe privat. Mes tjerash do të sqarohet edhe raportimi që ka të bëjë me sinjalizimin në fushën e sigurisë kombëtare dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

**4.1. Sinjalizimi i jashtëm** - është raportimi i informacionit jashtë organizatës punëdhënëse dhe mund të bëhet: (i) pasi është bërë sinjalizimi i brendshëm apo (ii) sinjalizim i drejtpërdrejt i jashtëm. Procedura e shqyrtimit të sinjalizimit të jashtëm është procedura e njëjte si ne rastin shqyrtimit të sinjalizimeve të brendshme. Pra organet kompetentë si Agjencia kundër Korrupsionit, për sektorin publik dhe organet rregullatorë përkatëse në sektorin privat, bëjnë shqyrtimin e rasteve të sinjalizimeve përmes hetimit administrativ

## TABELA NR.10

### SINJALIZIMI I JASHTËM MUND TË BËHET NË RASTET NË VIJIM:

- KUR KA TË BËJË ME DREJTUESIN E PUNËDHËNËSIT
- KUR KA RREZIK TË RËNDË, TË MENJËHERSHËM APO DËME TË PA KTHYESHME
- KUR PROVAT MUND TË FSHIHEN, APO ASGJËSOHEN NË RAST SE KRYHET SHKELJA
- KUR PROCEDURAT E BRENDSHME TË TRAJTIMIT TË SINJALIZIMIT JANË JO EFIKASES

**4.2. Sinjalizimi i jashtëm në sektorin publik** - iniciohet (parashtrohet) në Agjencinë kundër Korrupsionit. Ky institucion është organ i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e hetimit administrativ për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Kosovë. Agjencia shqyrton rastet në fushëveprimin e saj (korrupsionin dhe konfliktin e interesit), ndërsa për rastet tjera raporton tek organi kompetent për trajtim të mëtejshëm.

**4.3. Sinjalizim i jashtëm në sektorin privat** - iniciohet (raportohet) tek institucionet që shërbejnë si rregullatorë përgjegjës në fushat e ndryshme si në vijim: Administrata Tatimore e Kosovës; Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve; Odat (e avokatëve, e mjekëve, etj.); Banka Qendrore; Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik; inspektoratet; divizionet apo departamentet e ndryshme në kuadër të ministrive; agjencitë, etj.

**4.4. Sinjalizimi lidhur me sigurinë kombëtare dhe marrëdhëniet ndërkombëtare** – Siguria dhe mbrojtja kombëtare dhe marrëdhëniet ndërkombëtare janë vitale për sovranitetin dhe integritetin e vendit. Prandaj edhe Ligji, përcakton se rastet e sinjalizimit të brendshëm dhe jashtëm dhe të cilat kanë të bëjnë me fushat specifike të informacionit të klasifikuar, sigurisë, mbrojtjes kombëtare; inteligjencës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, i paraqiten organit kompetent në këto fusha.<sup>4</sup> Kjo nënkupton për të sinjalizuar për shkelje apo praktika të dyshimta në fushat përkatëse, kjo mund të bëhet jo në organizatën ku punon por tek institucioni kompetent. Por shtrohet pyetja, cili është organi kompetent? Në rast të sinjalizimit të informacionit të klasifikuar dhe inteligjencën, organ kompetent është Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI). Në rastet e sigurisë dhe mbrojtjes, si organ kompetent mund të jete Forca e Sigurisë, Policia e Kosovës dhe Këshilli i Sigurisë së Kosovës. Ministria e Punëve të Jashtme për shkak të mandatit dhe funksionit bashkërendues që ka me institucionet tjera në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, konsiderohet organi kompetent në këtë rast.

#### **TABELA NR.11**

##### **SEKTORI I SIGURISË NË KOSOVË PËRMBAN KËTO INSTITUCIONE:**

- FORCA E SIGURISË
- KËSHILLI I SIGURISË
- POLICIA
- AGJENCIA E INTELIGJENCËS
- AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

<sup>4</sup> Sipas këtij përkufizimi (neni 21 i Ligjit) në rastin e këtyre fushave, kemi dy lloje të sinjalizimit: sinjalizimin të organi kompetent (i brendshëm) dhe sinjalizimi publik.

## 5. SINJALIZIMI PUBLIK / SHPALOSJA E INFORMACIONIT

Hyrje: Fryma e ligjit është që fillimisht të provohet inicimi i sinjalizimit të brendshëm apo jashtëm, por sinjalizuesi mund të bëjë edhe sinjalizim publik. Në kuadër të këtij kapitulli bëhet shpjegimi i konceptit të sinjalizimit publik apo shpalosjes së informacionit.

**5.1. Shpalosja publike** - sinjalizimi publik mund të bëhet kur sinjalizuesi me arsye beson se: (i) do t'i nënshtrohet ndëshkimit nëse bënë raportim të brendshëm apo të jashtëm; (ii) ka gjasa që dëshmitë në lidhje me veprimet e dëmshme përkatëse do të fshihen ose do të shkatërrohen; (iii) në rast të kërcënimit të menjëhershëm për jetën, shëndetin publik, sigurinë, mjedisin, apo kur shkaktohen dëme në shkallë të gjerë apo të pariparueshme; (iv) nëse sinjalizimi i brendshëm dhe i jashtëm nuk është shqyrtuar nga autoritetet përgjegjëse.

**TABELA NR.12**

### **SINJALIZIMI PUBLIK MUND TË BEHET :**

- NË MEDIA
- TEK ORGANIZATAT JO QEVERITARE
- NË TUBIME/TAKIME/MBLEDHJE
- PUBLIKE
- PËRMES INTERNETIT/  
RRJETEVE SOCIALE
- POSTES ELEKTRONIKE

**5.2. Presumimi i pafajësisë** - Në rast se sinjalizuesi zgjedh të bëjë sinjalizim publik ai duhet të respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë të personit të akuzuar, të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe të mos pengoj zhvillimin e procedurave gjyqësore.

## **6. MBROJTJA E SINJALIZUESVE**

Hyrje: Të drejtat e sinjalizuesit dhe mbrojtja e tij janë themeli i këtij ligji. Ky kapitull trajton të drejtat e sinjalizuesit dhe mbrojtjen nga veprimet e dëmshme dhe dëmshpërblimin në raste të tilla. Po ashtu trajtohet edhe procedura dhe mbrojtja gjyqësore e sinjalizuesve.

**6.1. Mbrojtja e sinjalizuesve** - sinjalizuesi gëzon mbrojtje ligjore, dhe nuk mund të jetë subjekt i përgjegjësisë penale, civile apo administrative. Sinjalizuesi mbrohet nga çdo veprim i dëmshëm, i cili mund të merret nga punëdhënësi për shkak të raportimit apo shpalosjes se informacionit. Te njëjtën mbrojtje e gëzon edhe personi i lidhur me sinjalizuesin. Çfarëdo veprimi i dëmshëm është i pavlefshëm, dhe nuk do të ketë efekt.

## TABELA NR.13

### VEPRIMET E DËMSHME NGA TË CILAT MBROHET SINJALIZUESI:

- 1) SHKARKIMIN NGA PUNA
- 2) PEZULLIMIN NGA PUNA OSE TË NJË OSE MË SHUMË  
DETYRAVE
- 3) TRANSFERIMIN BRENDA OSE JASHTË INSTITUCIONIT  
PUBLIK OSE SUBJEKTIT PRIVAT PA PËLQIMIN E TIJ
- 4) ULJEN NË POZITË
- 5) ZVOGËLIMIN E PAGESËS
- 6) HUMBJEN E STATUSIT DHE PRIVILEGJEVE
- 7) MOS NGRITJEN NË POZITË
- 8) HEQJEN E TË DREJTËS PËR TË MARRË PJESË NË  
TRAJNIME
- 9) VLERËSIME NEGATIVE NË MARRËDHËNIEN E PUNËS;
- 10) ANULIMIN E NJË LICENCE OSE LEJE
- 11) PËRFUNDIMIN E NJË KONTRATE PËR MALLRA APO  
SHËRBIME
- 12) VEPRIME TË TJERA TË DËMSHME NË LIDHJE ME  
MARRËDHËNIEN E PUNËS

**6.2. Parashtrimi i Padisë** - në rast se Sinjalizuesi ka pësuar nga veprimet e dëmshme, sinjalizuesi ka të drejtë të ushtroj padi gjyqësore pa qenë i detyruar t'i shterojë mjetet juridike në procedurën e brendshme administrative në kuadër të punëdhënësit. Padia ushtrohet në afat prej 6 muajsh nga dita kur sinjalizuesi është vënë në dijeni dhe jo me vonë se 3 vite nga dita kur është ndërmarrë veprimi i dëmshëm. Padia në rast se ka të bëjë me nënpunës civil dorëzohet në Departamentin për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Për rastet e kategorive tjera, padia

dorëzohet në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatave Themelore, ku është selia e punëdhënësit apo ku është vendbanimi i sinjalizuesit.<sup>8</sup>

**6.3. Vendimet e gjykatës** - në rast kur gjykata kompetente pasi shqyrton rastin konkret dhe vërteton se sinjalizuesi ka pësuar nga një veprim i dëmshëm vendosë sipas rastit që: (i) ta kthejë në vendin e punës; (ii) kompensimin e dëmit; (iii) urdhëron punëdhënësin publik ose privat të ndër marrë veprime të caktuara. Lëndët që kanë të bëjnë me sinjalizimin shqyrtohen me prioritet nga Gjykatat.

**6.4. Barra e Provës** - është e drejta dhe detyrimi i palës që në një proces ligjor për të provuar atë që pretendon mbi një fakt ose të dhëna që kanë ndikim përcaktues në zgjedhjen përfundimtare të çështjes. Në të gjitha rastet kur sinjalizuesi apo personi i lidhur me sinjalizuesin pretendon se ka pësuar nga veprime të dëmshme për shkak të sinjalizimit, barra e provës i takon punëdhënësit pasi që veprimi i dëmshëm nuk ka lidhje shkakore me sinjalizimin.

**6.5. Masat e sigurimit të kërkesëpadisë** - në korpusin e garancive ligjore për mbrojtjen e të drejtave të sinjalizuesit është edhe e drejta e propozimit për masat e sigurimit të kërkesëpadisë në gjykatën kompetente sipas legjislacionit në fuqi. Realizimi i të drejtave të individit në procedurë civile mund të zgjasë shumë, dhe për këtë arsye, paraqitet nevoja për të shqiptuar masat e përkohshme të sigurisë deri në vendosjen e çështjes kryesore.

**6.6. Masat (gjobat) administrative** - Gjykata kompetente shqipton sanksionet kundërvajtëse në rast të pengimit të sinjalizimit, dështimit të institucionit rreth zbatimit të këtij ligji apo mbrojtjes së sinjalizuesit. Gjykata mund të shqiptojë dënime me gjobë për personin juridik (punëdhënësin) të sektorit publik apo privat dhe për personin fizik të personit juridik nëse dështojnë t'i përmbushin detyrimet e tyre në zbatimin e këtij ligji. Organ kompetent për fillimin e procedurës kundërvajtëse për sektorin publik është Agjencia kundër Korrupsionit, ndërsa Inspektorati i Punës për sektorin privat.

---

<sup>8</sup> Padia ushtrohet sipas dispozitave të Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Prishtinë: Viti VI / Nr. 82 / 21 Tetor 2010. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2707>

## TABELA NR.14

### GJOBAT ADMINISTRATIVE QE MUND T'U SHQIPTOHEN AUTORITETEVE PËRKATËSE:

- ZYRTARI PËRGJEGJËS, 300 DERI 2000 EURO
- PËR SUBJEKTIN JURIDIK PUBLIK DHE PRIVAT, PREJ 500 DERI 20 000 EURO

## PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME

Fusha e sinjalizimit dhe mbrojtja e sinjalizuesve është një fushë e re dhe sfiduese dhe zbatimi i Ligjit nuk është një proces i lehtë. Zbatimi i këtij ligji, kërkon angazhim dhe inkurajim për të gjithë qytetarët, institucionet publike, sektorin privat, mediat, dhe shoqërinë civile, në mënyrë që të krijohet një qasje e integruar për zbatimin e suksesshëm të ligjit.

1. Të punësuarit para se të sinjalizojnë është mirë të konsultojnë ligjin dhe burimet tjera, që të kuptojnë mënyrat e raportimit dhe të drejtat e tyre.
2. Institucionet ligjzbatuese të kompletojnë legjislationin e duhur për zbatimin e Ligjit. Është e pa arsyeshme vonesa e nxjerrjes së akteve nënligjore, në veçanti vonesa në miratimi e Rregullores për sinjalizim të brendshëm.
3. Organizatat punëdhënëse të sektorit publik dhe privat duhet të njoftojnë personelin e tyre rreth procedurave të sinjalizimit dhe për caktimin e zyrtarit përgjegjës, por edhe të krijohen kushte dhe ambient i sigurt për punën e tyre.
4. Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve përgjegjës, duhet të jetë një proces progresiv sepse raportet dhe hulumtimet tregojnë se ka mungesë të njohurive rreth procedurave të sinjalizimit. kodit të etikës, plani i integritetit, do rrisë efikasitetin e zbatimit të ligjit.



5. Bashkëpunimi mes zyrtarit përgjegjës dhe njërive apo personave zyrtarë brenda institucioneve të cilat janë të dizajnuara për përgjegjshmërinë dhe sundimin e ligjit si: komiteti i auditimit; auditorit i brendshëm: zyrtari për të dhënat personale; komisioni disiplinorë; zbatimimi i kodit të etikës, plani i integritetit, do rrisë efikasitetin e zbatimit të ligjit.
6. Avokimi nga ana e shoqërisë civile dhe mediave përmes veprimeve sensibilizuese, janë thelbësore në zbatimin e ligjit.
7. Monitorimi nga institucionet publike: Agjencia kundër Korrupsionit; Komisionet Parlamentare; Kuvendi i Kosovës, duhet të jetë efikas, afirmativ dhe i vazhdueshëm.

## REFRENCAT:

Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

[https://www.echr.coe.int/Documents/Convention\\_SQL.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_SQL.pdf)

Ligji Nr. 065/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 22 /18 dhjetor 2018, Prishtinë.

Ligji nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Prishtinë: Viti V/ Nr. 82 /21 Tetor 2010.

Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/21 Qershor 2016.

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=12559>

Ligji Nr.02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, Gazeta Zyrtarë e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, Prishtinë: VITI III/ Nr. 10/01 Mars 2007.

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2440>.

Raportin e Lëvizjes Fol “ Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve - Sfidat në Praktike” korrik 2020

<http://levizjafol.org/wp-content/uploads/2020/06/Raport-Ligji-per-Mbrojtjen-e-Sinjalizuesve-1.pdf>



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur  
Kosovo Foundation for Open Society  
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo